


PËRMBLEDHJE JOTEKNIKE

EMËRTIMI I PROJEKTIT:
"STACION TRANSFERIMI PËR MBETJE INERTE
DHE INDUSTRIALE"

VENDNDODHJA E ZONËS SË ZHVILLIMIT:
SHKALLNURË, DURRËS
Zona Kadastrale 3385
Nr. Pasurie 61/1; Sipërfaqe e përgjithshme 4300 m²
Nr. Pasurie 61/2; Sipërfaqe e përgjithshme 5800 m²

Hartoi:
Ekspert Mjedisi i licencuar
KLEVIS BREGU



Për investitorin GANT CONSTRUCTION:
Administratori
LEONARD QESARI



PHARMACEUTICAL INDUSTRY

PHARMACEUTICAL INDUSTRY
INDUSTRY

PHARMACEUTICAL INDUSTRY
INDUSTRY

PHARMACEUTICAL INDUSTRY
INDUSTRY



1. PËRSHKRIMI I OPERATORIT DHE PROJEKTI

Të përgjithshme

Ky relacion joteknik hartohet me kerkese te zhvilluesit "GANT CONSTRUCTION" SH.P.K me nr. NIPT: K62805404K, i cili do te paraqese prane Agjencise Kombetare te Mjedisit dokumentacionin e nevojshem per pajisje me Leje mjedisore te tipit B, per aktivitetin:

▪ "Stacion transferimi për mbetje inerte dhe industriale"

me vendodhje ne Shkallnure, Bashkia Durrës, Rrethi Durrës, Qarku Durrës.

Zhvilluesi i aktiviteve eshte shoqeria "GANT CONSTRUCTION" SH.P.K, me vend ushtrimi aktiviteti: Parku Industrial Rrashbull, Manskuri, Durres.

Objekti i kesaj kerkese eshte pajisja me Leje Mjedisore tipi B.

Ky projekt per vleresim po kryen njoftimin per proceduren e degjeses me publikun sipas VENDIM Nr. 419, datë 25.6.2014 dhe me pas do te kryeje te gjitha hapat per pajisje me Leje Mjedisore te tipit B.

Sipas LIGJ Nr. 10 448, datë 14.7.2011, "PËR LEJET E MJEDISIT", Shtojca I:

Lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C në varësi të kapacitetit prodhues kufi; per aktivitetet e mesiperme: "**Menaxhim i mbetjeve**", kemi klasifikimin sipas ID te meposhtme:

ID 5.10 a. Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme që nuk përmendet më lart

ID 5.10 b. Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme që nuk përmendet më lart

ID 3.11 Fraksionimi i mbetjeve inerte

Të dhëna teknike:

Siperfaqja totale e vendit ku do te zhvillohet projekti nga subjekti GANT CONSTRUCTION SH.P.K eshte 10100 m², me shtrirje ne zonen kadastrale 3385.

Specifikime teknike:

- ✓ Kapaciteti i projektuar i stacionit te transferimit te mbetjeve te rrezikshme eshte **30 ton / ditë**; (mbetje inerte maksimumi 20 ton / dite; konform Vendim Nr. 575, datë 24.6.2015 "PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE INERTE").
- ✓ Kapaciteti i projektuar i stacionit te transferimit te mbetjeve jo te rrezikshme eshte **100 ton / ditë**; (mbetje inerte maksimumi 20 ton / dite ; konform Vendim Nr. 575, datë 24.6.2015 "PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE INERTE").
- ✓ Kapaciteti i projektuar i perpunimit te mbetjeve ne fronto eshte **160 m³ / ditë (20 m³ / orë , 8 orë pune)**.

2. VENDNDODHJA E USHTRIMIT TË AKTIVITETIT

Shoqeria "GANT CONSTRUCTION" SH.P.K ushtron aktivitetin e saj ne adresen: Parku Industrial Rrashbull, Manskuri, Durres dhe Nr. NIPT: K62805404K.

Territori ku shoqeria zhvillon aktivitetin e saj eshte ne pronesi te shoqerise dhe nuk cenon territoret e zonave te mbrojtura mjedisore, kurores se gjelber, hapesires ujore rekreative, parkut urban, zonave te caktura per agroturizem, kala, objekte fetare, rrenoja/arkeologji, ujera siperfaqesore etj.

Ajo gjithashtu eshte larg zonave te banuara, shkollave dhe kopshteve.

E gjithe siperfaqja ku do te zhvillohet aktiviteti "**Stacion Transferimi per Mbetje Inerte dhe Industriale**", perbehet nga dy parcela dhe do te kete nje ndarje te tille:

Pasuria me numer 61/2 do te sherbeje si: "Stacion transferimi per mbetje inerte".

Pasuria me numer 61/1 do te sherbeje si: "Stacion transferimi per mbetje te tjera industriale".

Ky stacion transferimi do te sherbeje per grumbullimin dhe magazinimin e mbetjeve te ndryshme dhe gjithashtu fraksionimin e mbetjeve inerte. Bashkengjitur certifikatat e pronesise.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E REGJISTRIMIT TË PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË 2083363 PËR VËRTETIM PRONËSIE

Zyra e Regjistrimit Z.V.R.P.P. DURRËS Zona Kadastrale Nr. 3385
Numri i Pasurisë 61/1 Volumi 2 Faqe 84
Adresa e Pasurisë SHKALLNUR
Lloji i Pasurisë ARE
Sipërfaqja Totale 4300.00 m²
Nga kjo : Sa Truall - Nga kjo : Sha Ndërtesa -
Nqs pallat: Kuota e pjesëmarrjes - %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË

Zoti (Zotënjtë)

Emri	Atësia	Mbiemri	Pjesa	Adresa
GANT	CONSTRUCTION	SHPK	1/1	DURRES

- është pronar i pasurisë me numër 61/1 _____
- janë bashkëpronarë sipas pjesëve më lart _____
- është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi _____
- kufizimet e pasurisë janë : V _____, L _____, J _____, P _____

Kjo çertifikatë plotësohet në përputhje me
Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të
Paluajtshme.

Kjo çertifikatë lëshohet sipas kërkesës së
paraqitur nga i (të) interesuarj (t)
më datë 28/8/2020 Nr. 12678

Data e lëshimit të çertifikatës
28/8/2020

Lëshuesi i çertifikatës
REGJISTROESI
ARTUR ÇOBANI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

ÇERTIFIKATË REGJISTRIMI PRONËSIE

PRONARI/BASHKËPRONARËT		
Emri i Personit Juridik	Nr. Personal NIPT	Pjesa(-/-)
GANT CONSTRUCTION	K62805404K	1/1

Numri i Pasurisë	61/2		
Kodi Unik	3385008039		
Zona Kadastrale	3385		
Lloji i Pasurisë	ARE		
Sipërfaqja e pasurisë (m2)	Totali: 5800	Truall: 0	Ndërtesë: 0
Vlera Aktuale e Pasurisë	29000		
Adresa e Pasurisë	DURRËS, SHKALLNURË, Rr.: -		

DREJTORI
Viola Hima

Viola
Hima

Digitally signed by
Viola Hima
Date: 2021.08.09
10:33:07 +02'00'

Data e lëshimit 09/08/2021



Vlerat elektronicisht nga Drejtori
Viola Hima
Data: 2021/08/09 11:33:14 +02'00'
K62805404K2021080911331775L1014



Këtu - Ky dokument është gjeneruar dhe nënshkruar
në një proces automatik nga një sistem elektronik i Agjencisë Shtetërore e Kadastrës.

3. OBJEKTIVAT E PROJEKTIT DHE QËLLIMI

Objektivi i pare i ketij aktiviteti do te jete te identifikojë ndikimet e mundshme negative mjedisore ketij instalime te cilat jane:

- Emetimet ne ajer dhe zhurmat
- Ndikimi ne flore/faune
- Mbetjet e gjeneruara nga aktiviteti
- Ndikime social-ekonomike
- Ndikim ne cilesine e jetes ne qendrat e banuara
- Ndikim ne rritjen e trafikut rrugor
- Ndikim ne peizazhin e zones

Objektivi i dyte konsiston ne gjetjen e alternativave miqesore me mjedisin:

- Njohja me projektin dhe teknologjine e tij.
- Njohja me natyren e operacioneve te nevojshme ne mjedis.
- Njohja me vleren natyrore dhe mjedisore te zones dhe siperfaqes ku do te zhvillohet aktiviteti.
- Njohja me infrastrukturen ekzistuese dhe nevojen per infrastrukture te re per projektin.
- Njohja me lendet e para qe do te perdoren per zhvillimin e aktivitetit.

Identifikimi i ndikimeve

Permes te cilit percaktohet nderveprimi mjedis-projekt dhe identifikohen ndikimet e mundshme.

Vleresimi i ndikimeve

Vleresimi i ndikimeve ka te beje me vete rendesine e ndikimeve dhe eshte faza me e rendesishme per zbatuesit e projektit sepse argumenton çdo ndikim negativ dhe perafron ate me objektivisht me teresine e bashkeveprimeve midis projektit dhe mjedisit. Kriteret e perdorur per vleresimin e rendesise se ndikimeve variojne dhe drejtohen kryesisht nga vlerat e mjedisit te ndikuar.

Shtrirja fizike

Vlereson siperfaqen apo dimesionin hapsinor te nje ndikimi te dhene ne raport me burimin qe gjeneron ate ndikim.

Kohezgjatja e ndikimit

Vlereson se sa do te zgjase nje ndikim i caktuar ne dimesionin kohe (ndikim i perhershem apo i perkoshem).

Kthyesmeria

Vlereson mundesine e kthimit te mjedisit te ndikuar ne gjendjen e tij te mepareshme (aftesia per tu rehabilituar dhe regjeneruar).

Rendesia

Realizon nje vleresim total te tre permasave te mesiperme dhe njekohesisht thekson vemendjen qe duhet patur per administrimin e ndikimit.

Qellimi i projektit te propozuar ne kete permbledhje joteknike konsiston ne menaxhimin efektiv te mbetjeve.

E gjithë siperfaqja e cila perbehet nga dy parcela dhe do te kete nje ndarje te tille: Stacion transferimi per mbetje inerte – Pasuria me numer 61/2.

Stacion transferimi per mbetje te tjera industriale – Pasuria me numer 61/1.

Aktivitetet e parashikuara brenda siperfaqes se Stacionit te Transferimit per Mbetje Inerte dhe Industriale do te kene perkatesisht ndarjen e meposhtme:

1. "Stacion transferimi per mbetje inerte" qe do te menaxhohet si aktivitet ne parcelen me nr. Pasurie 61/2;

Mbetjet inerte te cilat vine nga subjekte te ndryshme te gjenerimit te mbetjeve, do te grumbullohen, seleksionohen dhe ato mbetje te cilat mund ti nenshtrohen procesit te fraksionimit ne makinerine e frontose, do ti nenshtrohen ketij procesi me qellim, thyerjen, copezimin dhe fraksionimin e tyre deri ne produktin final te imet, te gatshem per tregtim. Ajo pjese e mbetjeve qe nuk mund te perpunohen do te magazinohen perkohesisht ne kete stacion transferimi dhe trajtimi i tyre final do te behet permes kontrates me te trete, nga subjekte te licencuara per kete qellim.

2. "Stacion transferimi për mbetje industriale" qe do te menaxhohet si aktivitet ne parcelen me nr. Pasurie 61/1;

Qellimi konsiston ne magazinimin e mbetjeve sipas te gjitha kriterëve te percaktuara konform legjislacionit ne fuqi. Per keto mbetje do te realizohet vetem ruajtje/magazinim ne ambjentet e percaktuara per kete qellim, deri ne momentin e transferimit per trajtim perfundimtar permes kontratave me subjekte te licencuara per trajtimin e tyre. Mbetjet te cilat do te magazinohen ne kete stacion transferimi do te jene kryesisht mbetje te lengeta, te rrezikshme dhe jo te rrezikshme, te kategorise se vajrave, mbetje me permbajtje nafte etj.


PLANI I ORGANIZIMIT : "STACION TRANSFERIMI PER MBETJET INDUSTRIALE TE SUBJEKTIT GANT CONSTRUCTION
SILP.K"

VENDODHJA SHKALLNORE, DURRËS. ZIVILLUES "GANT CONSTRUCTION" sh.p.k

Shkalla 1 : 150

LEGJENDA

- ① HAPËSIRË DEPOZITIMI
E PËRKHOSHME (LENDË E PARË)
- ② HAPËSIRË FRANSIZIONIMI
(FRONTOLJA)
- ③ HAPËSIRË MAGAZINIMI
- ④ HAPËSIRË MAGAZINIMI (SILLOSE)
- ⑤ SHËSHI / SELEKTIMI NDARJES SE MBËTJEVE
(LENDË E DËJTË)
- ⑥ HAPËSIRË PËRQIMI DHE VEND PËR LARJEN E
MJETEVE TE TRANSPORTIT (KAMIONA)



4. PROCESI TEKNOLOGJIK

Proceset teknologjike ne kete projekt, jane ato te Fraksionimit dhe Magazinimit te mbetjeve.

- ✓ Kapaciteti i projektuar i stacionit te transferimit te mbetjeve te rrezikshme eshte **30 ton / ditë**;
(mbetje inerte maksimumi 20 ton / dite; konform Vendim Nr. 575, datë 24.6.2015 "PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE INERTE").
- ✓ Kapaciteti i projektuar i stacionit te transferimit te mbetjeve jo te rrezikshme eshte **100 ton / ditë**;
(mbetje inerte maksimumi 20 ton / dite ; konform Vendim Nr. 575, datë 24.6.2015 "PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE INERTE").
- ✓ Kapaciteti i projektuar i perpunimit te mbetjeve ne fronto eshte **160 m³ / ditë (20 m³ / orë , 8 orë pune)**.

PËRSHKRIMI TEKNOLOGJIK I AKTIVITETEVE

Aktiviteti si veprimtari kryesore ka fraksionimin e mbetjeve inerte dhe magazinimin e tyre sipas kushteve te nevojshme.

Pajisjet qe do te perdoren (ne rastin e materialeve inerte makineria e frontose); jane bashkekohore dhe te lehta ne perdorim dhe manovrim, nuk ka çlirimte të gazrave apo shkarkime të tjera të dëmshme të rrezikshme e me natyrë ndotjeje.

Menaxhimi i procesit teknologjik te mbetjeve inerte

Stacioni i transferimit te mbetjeve te rrezikshme dhe jo te rrezikshme inerte, te cilat gjenerohen nga zhvillimi i aktiviteteteve te ndertimit ne territorin e Shqipërisë, aplikon metodat e grumbullimit dhe perpunimit per mbetjet e rrezikshme dhe jo te rrezikshme sipas Ligjit per Menaxhimin e Integruar te Mbetjeve.

Operacionet e menaxhimit

- Hyrja
- Regjistrimi
- Peshorja
- Klasifikim/Etiketim dhe Ambalazhim i mbetjeve sipas rrymave dhe kodeve perkatese
- Seleksionimi dhe ndarja e mbetjeve
- Procesi i fraksionimit te mbetjeve inerte
- Magazinimi i mbetjeve inerte

Operacionet qe do te zhvillohen per mbetjet inerte, do te behen ne perputhje me peshen dhe qendrushmerine e materialit duke siguruar qe pesha mos tejkaloje rezistencen e ferkimit dhe te

krijohen rreshqitje.

Pasi hyne ne instalim, mbetjet inerte peshohen ne peshoren perkatese dhe dergohen ne stacionin e transferimit, ku fillimisht grumbullohen ne hapesiren e depozitimit te perkohshem per mbetjet inerte (lenda e pare; sipas planimetrise referuar), ku i nenshtrohen diferencimit/selektimit, per ato te cilat mund te kalojne per fraksionim ne makinerine e frontose.

Do te kryhet copezimi / thyerja per ato mbetje te cilat do te hyne ne makinerine e frontose. Ato mbetje te cilat klasifikohen per fraksionim, kalojne ne hapesiren e posacme (sipas planimetrise referuar) dhe pas fraksionimit ne hapesiren e magazinimit, te gatshme per tregtim. Per mbetjet qe nuk mund te fraksionohen, do te behet magazinimi i tyre sipas te gjitha kriterëve te legjislacionit ne fuqi per ruajtjen e mbetjeve inerte; do te ruhen ne perkohesisht ne vendndodhje dhe do te trajtohen nga subjekte te licencuara per trajtimin e tyre, permes kontratave qe do te lidhen me te trete.

Për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve inerte do të përdoren kontenierë të transportueshëm (roll- off) apo kontenierë të hapur nga sipër me kapak.

Për shkak të vetive materiale qe mbetjet inerte kanë si psh: dendësia e lartë apo mprehtësia e tyre, kontenierët e grumbullimit te tyre duhet te jene te forte dhe me perforcim shtese. Për transportin e këtyre kontenierëve janë të nevojshëm kamionë vetëshkarkues dhe kamionë me vagonetë të kthyeshme.

Persa i perket procesit te trajtimit (fraksionimit) te mbetjeve inerte, ekzistojne impiante stacionare te levizshme te trajtimit (si FRONTOJA), kapaciteti i mekanizmit te te cilave mund te shkoje edhe deri ne 300 ton/h, kjo varësi të llojit dhe përbërjes së materialit hyrës dhe madhësisë se kerkuar te grimcave perfundimtare qe do te dalin.

Makineria e frontosë që do të përdoret në këtë rast ka një kapacitet përpunimi (fraksionimi) 20 m³/orë. Duke llogaritur 8 orë pune në ditë përgjatë një dite, kjo makineri do te funksionojë me një kapacitet ditor pune prej 160 m³/ditë.

Copëtimi i materialit inert në Fronto

Frontoja eshte nje pajisje e cila ka nje bunker te voget per futjen e lendes inerte dhe dy nofulla te fuqishme te perbera nga material special, qe nepermjet levizjes se tyre realizohet copetimi i materialit.

Fraksionimi i materialit nepermjet sistemit te sitosjes

Pas procesit te copetimit te materialit ne fronto, materiali i dale nga frontoja ka ne perberje te tij nje perzierje granulometrike, nga materiale inerte te trajtes ranore deri ne copeza te medha me

dimensione deri ne 5 cm. Per ndarjen e ketyre fraksioneve, materiali kalon ne nje site me dy kate me siperfaqe 10 m², ku pjesa e imet qe del nga pjesa e poshtme e sites dhe qe perfaqeson materialin me karakteristikat e reres, kalon ne nje larese rere, ku realizohet procesi i larjes se tij dhe me tej nepermjet nje transportieri kalon ne vend grumbullimin e reres, ku trajtohet si produkt i gatshem se bashku me reren e marre gjate procesit. Pjesa mbi site qe perbehet nga material i trashe, nepermjet transportierit kalohet ne procesin e grimcimit ne mullinj.

Materiali i dale siper sites nepermjet transportierit kalon ne procesin e grirjes te mullinjte, te cilet jane te vendosur ne seri per te realizuar nje proces sa me te plote te therrmimit te materialit inert. Parimi i punes se mullinjeve eshte i tipit me çekiçe. Pasi materiali therrmohet ne mullinj, nepermjet transportierit kalon perseri ne nje proces sitosje.

Procesi sitosjes pas bluarjes se materialit

Pasi materiali eshte bluar ne mullinj i nenshtrohet procesit te sitosjes ne nje site me dy kate. Nga ky proces fitohen dy fraksione qe perfaqesohen nga pluhura teper te imeta dhe pluhura te imeta qe nepermjet transportiereve depozitohen ne venddepozitimet e tyre te perkohshme, ku do te magazinohen. Pjesa tjeter e materialit qe mbetet mbi site nepermjet transportierit kalon ne nje proces tjeter sitosje qe realizohet nepermjet sites, qe eshte perseri nje site me dy kate dhe ne te cilen realizohet fraksionimi i katër fraksioneve. Duhet te theksohet se te gjithë proceset e siper permendura gjithmone shoqerohen me lagje me uje. Materialet e seleksionuara depozitohen ne sheshin perkates sipas granulometrise te pershkruar me siper per tre fraksionet rere 0-5, granil 1 dhe 2.

Impianti i fraksionimit te materialit inert

Shoqeria "GANT CONSTRUCTION" SH.P.K ka investuar per aplikimin e nje teknologjie bashkekohore te standarteve europiane. Ky instalim eshte teper eficient persa i takon perdorimit te energjise, pjese teknologjike te ndryshme te tij ndertohen ose modifikohen me te reja, te cilat permiresojne eficencen dhe optimizojne perdorimin e energjise dhe ndikimin e tij ne mjedis.

Linja teknologjike sipas proceseve qe realizon perbehet nga keto njesi:

1. Hapësirë depozitimi e përkohshme (Lënda e parë)

Ne kete hapësire depozitohet lenda e pare qe vjen nga subjekte/kompani te licencuara qe gjenerojne keto mbetje. Vendi i grumbullimit eshte edhe stacioni i pare i mbetjeve inerte. Materiali inert qe depozitohet ketu do te jete gjithmone ne gjendje gjysme te lagur, per efekt te eliminimit te çlirimit te pluhurave gjate procesit te thyerjes/ndarjes se tij permes pajisjeve te posaçme per kete proces. Vendi paraprak i grumbullimit do te kete nje kapacitet te konsiderueshem volumetrik dhe do te jete teper rezistent ndaj forcave mekanike. Ne kete vend grumbullim do te shkarkohen mbetjet inerte qe do te

vine ne instalim perpara se ato t'ju nenshtrohen procesit te fraksionimit ne makinerine e frontose, duke u bere ndarja dhe seleksionimi i tyre ne mbetje te cilat do te kalojne fillimisht per fraksionim dhe me pas do te magazinohen dhe mbetje te cilat do t'ju nenshtrohen magazinimit direkt.

2. Hapësirë fraksionimi (Frontoja)

Fraksionimi i mbetjeve inerte ne makinerine e frontose deri ne fraksione te imeta ose shume te imeta.

3. Hapësirë magazinimi

Ne kete shesh do te behet depozitimi i produktit final pas fraksionimit ne makinerine e frontose gati per magazinim / tregtim. Per mbetjet te cilat nuk hyne ne perpunim do te behet magazinim i tyre sipas te gjitha kushteve te ruajtjes per mbetjet inerte, magazinim qe do te realizohet ne ambientet e jashtme ne konteniere te posaçem plastike/metalike dhe me pas transportim drejt subjekteve te licencuara per trajtimin perfundimtar te tyre.

Sa i perket **Stacionit te Transferimit te Mbetjeve Inerte**, punimet qe do te realizohen per pergatitjen e ketij aktiviteti konsistojne ne:

- *Germim; skarifikim i siperfaqes (sheshit)*
- *Mbushje e shtreses me gjeomembrane*
- *Mbushje e shtreses me gjeotekstil PVC*
- *Mbushje dhe ngjeshje me argjile e siperfaqes perfundimtare*
- *Ndertimi i sistemit te kanalizimeve*
- *Tuba te perdorura per drenazhimin*

Operacionet e menaxhimit te mbetjeve te tjera industriale

Stacioni i transferimit te mbetjeve te tjera industriale, mbetje te cilat gjenerohen nga industri te ndryshme qe operojne ne Republiken e Shqiperise, aplikon metodat e grumbullimit dhe ruajtjes per mbetjet e rrezikshme dhe jo te rrezikshme sipas Ligjit per Menaxhimin e Integruar te Mbetjeve.

- Hyrja
- Regjistrimi
- Peshorja
- Klasifikim/Etiketim dhe Ambalazhim i mbetjeve sipas rrymave dhe kodeve perkatese
- Stacioni i transferimit te mbetjeve te ndryshme industriale

Hapesira e stacionit te transferimit per mbetje e ndryshme industriale, eshte e organizuar ne disa zona:

1. Sheshi i selektimit / ndarjes se mbetjeve (Lënda e parë)

Ne kete shesh vine mbetje qe gjenerohen nga subjektet e ndryshme dhe behet selektimi / ndarja e tyre, per tu magazinuar me pas.

2. Hapësirë magazinimi

Magazinimi i mbetjeve do te realizohet ne ambjente te pershtatshme ne instalim, konform te gjitha kushteve te ruajtjes per mbetje e rrezikshme. Magazinimi sipas llojit te mbetjeve te percaktuara sipas Katalogut Shqiptar te Mbetjeve do te kryhet ne depozita me nje kapacitet prej 1000 litra, te organizuara ne kate dhe pershtatshme dhe te ndara sipas kategorive te mbetjeve qe do te magazinohen ne ambjentet e aktiviteve.

Keto objekte magazinimi do te jene sipas te gjitha kushteve te pershtatshme per ruajtjen e mbetjeve, te izoluara plotesisht, te vendosura ne zona te pershtatshme te instalimit, duke respektuar te gjitha distancat nga siperfaqja e tokes, gjithashtu edhe nga njera tjetra.

Objektet e magazinimit do te jene gjithashtu te pajisura me shenime dhe etiketat perkatese per secilin lloj mbetjesh, te specifikuara per mbetje e rrezikshme.

P.sh: Depozitat e ruajtjes se mbetjeve te lengeta do te jene te vendosura ne shtrese betoni, te rrethuara ne lartesi deri ne 15% te kapacitetit te depozitave dhe ne shtrese te padeptueshme, per te shmangur cdo ndotje te mundshme, ne rast derdhjeje aksidentale.

Magazinimi i mbetjeve do te realizohet me depozita me kapacitet 1000 litra dhe gjithashtu me sillose apo objekte te tjera magazinimi, ne varesi te llojit te mbetjes. Eshte llogaritur nje sasi e perafert prej 50 depozitash fillimisht dhe me pas ne varesi te sasise te mbetjeve qe do te pranohen do te behet shtimi i tyre. Magazinimi do te jete i organizuar ne kate. Mbetjet te cilat jane projektuar per tu ruajtur ne kete instalim do te pranohen deri ne permbushjen e kapacitetit maksimal te tyre, percaktuar ne kete raport dhe me pas do te behet transportim i tyre drejt subjekteve te licencuara per trajtim kur te kete mbi kalim te volumit dhe gjithashtu duke respektuar kohen e percaktuar te ruajtjes ne instalim per mbetje te rrezikshme dhe mbetje jo te rrezikshme.

3. Hapësirë parkimi dhe vend për larjen e mjeteve të transportit

Ne kete hapesire do te behet parkimi i mjeteve teknologjike dhe larja e kamioneve te shkarkimit me qellim shmangien e çdo ndotjeje te mundshme ne mjedisin rrethues, qe mund te vije nga mbetje

e ndryshme te ngarkuara.

Sa i perket stacionit te transferimit te mbetjeve te ndryshme industriale, punimet qe do te realizohen per pergatitjen e ketij aktiviteti konsistojne ne:

- *Germim; skarifikim i siperfaqes (sheshit)*
- *Mbushje e shtreses me gjeomembrane*
- *Mbushje e shtreses me gjeotekstil PVC*
- *Mbushje dhe ngjeshje me argjile e siperfaqes perfundimtare*
- *Ndertimi i sistemit te kanalizimeve*
- *Tuba te perdorura per drenazhimin.*

Lloji, volumi, konsumi dhe prodhimi i lëndëve të para

Lëndët e para, qe do te perdoren ne keto aktivite do te jene mbetje inerte te cilat do te futen ne fraksionim per te marre produktin final te fraksionuar, mbetje te tjera industriale dhe cdo gje tjeter qe do te nevojitet pergjate punes per magazinimin e mbetjeve.

Materiale ndihmese te tjera sigurohen ne rruge tregtare te leverdisshme.

Lëndë të para ndihmëse, jane naftë dhe vajra lubrifikante per mjetet teknologjike qe do te transportojne lenden e pare. Kamiona veteshkarkues per transportin dhe shkarkimin e lendes se pare. Energji elektrike nga rrjeti sipas rastit dhe nevojës qe do te kete ne zhvillimin e aktiviteve edhe per sherbime te tjera. Uje i cili do te sigurohet me autobote per ate sasi minimale qe do te nevojitet. Gjithashtu furnizimi me uje do te behet edhe nga lagunazhi natyror i krijuar nga mbledhja e ujerave te shiut.

Lendet ndihmese te tjera te cilat do te sherbejne pergjate fazes ndertimore do te jene:

- Gjeomembrane
- Gjeotekstil PVC
- Argjile
- Tuba per drenazhim
- Gure
- Granil
(sipas preventivit te punimeve).

Lende ndihmese te cilat do te sigurohen nga tregu vendas.

STACION TRANSFERIMI PËR MBETJE INDUSTRIALE

Koordinatat sipas sistemit koordinativ
KRG-JSH

Koordinatat sipas sistemit koordinativ
GAUS-KRUGER

	X		Y		X		Y	
1.	462077.93		4574215.19		4378456.88		4575265.78	
2.	462119.93		4574230.87		4378499.06		4575280.97	
3.	462138.13		4574216.31		4378517.10		4575266.20	
4.	462123.57		4574168.15		4378501.98		4575218.21	
5.	462154.93		4574119.43		4378532.78		4575169.12	
6.	462159.41		4574088.63		4378536.91		4575138.26	
7.	462151.29		4574073.51		4378528.61		4575123.24	
8.	462151.57		4574020.87		4378528.29		4575070.59	
9.	462155.35		4574003.65		4378531.87		4575053.32	
10.	462158.85		4573995.81		4378535.28		4575045.44	
11.	462136.87		4573991.89		4378513.25		4575041.77	
12.	462132.39		4574025.49		4378509.16		4575075.43	
13.	462129.73		4574044.53		4378506.72		4575094.50	
14.	462130.01		4574075.05		4378507.35		4575125.02	
15.	462130.29		4574100.95		4378507.93		4575150.92	
16.	462132.81		4574117.61		4378510.64		4575167.55	
17.	462113.49		4574150.65		4378491.70		4575200.82	
18.	462105.51		4574164.09		4378483.87		4575214.35	
19.	462092.63		4574198.81		4378471.39		4575249.23	

STACION TRANSFERIMI PËR MBETJE INERTE

Parcela me Nr. Pasurie 61/2

	Koordinatat sipas sistemit koordinativ KRGJSH		Koordinatat sipas sistemit koordinativ GAUS-KRUGER	
	X	Y	X	Y
1.	462130.01	4574075.05	4378507.35	4575125.02
2.	462151.29	4574073.51	4378528.61	4575123.24
3.	462151.57	4574020.87	4378528.29	4575070.59
4.	462155.35	4574003.65	4378531.87	4575053.32
5.	462158.85	4573995.81	4378535.28	4575045.44
6.	462136.87	4573991.89	4378513.25	4575041.77
7.	462132.39	4574025.49	4378509.16	4575075.43
8.	462129.73	4574044.53	4378506.72	4575094.50

STACION TRANSFERIMI PËR MBETJE INDUSTRIALE Parcela me Nr. Pasurie 61/1				
	Koordinatat sipas sistemit koordinativ KRGJSH		Koordinatat sipas sistemit koordinativ GAUS-KRUGER	
	X	Y	X	Y
1.	462077.93	4574215.19	4378456.88	4575265.78
2.	462119.93	4574230.87	4378499.06	4575280.97
3.	462138.13	4574216.31	4378517.10	4575266.20
4.	462123.57	4574168.15	4378501.98	4575218.21
5.	462154.93	4574119.43	4378532.78	4575169.12
6.	462159.41	4574088.63	4378536.91	4575138.26
7.	462151.29	4574073.51	4378528.61	4575123.24
8.	462130.01	4574075.05	4378507.35	4575125.02

9.	462130.29	4574100.95	4378507.93	4575150.92
10.	462132.81	4574117.61	4378510.64	4575167.55
11.	462113.49	4574150.65	4378491.70	4575200.82
12.	462105.51	4574164.09	4378483.87	4575214.35
13.	462092.63	4574198.81	4378471.39	4575249.23
14.	462078.07	4574215.33	4378457.02	4575265.91

5. MENAXHIMI I INSTALIMIT

Aktivitetet e parashikuara marrin ne konsiderate masat e nevojshme per te siguruar qe menaxhimi i tyre te kryhet pa demtuar shendetin e njeriut dhe pa i sjelle deme mjedisit, vecanerisht:

- Pa krijuar rreziqe per ujin, ajrin, token, floren dhe faunen.
- Pa shkaktuar pengesa nga zhurmat.
- Pa demtuar peisazhin.

Një synim tjetër është të përcaktojë e rekomandojë masa teknike organizative për zbutjen e ndikimeve negative që mund të krijohen gjatë zhvillimit të aktivitetit.

Në këtë aktivitet të subjektit do te punesohet nje numer prej **7-10 punonjësish** për kryerjen e punës dhe funksionimin e saj në vazhdimësi.

Ndotja e mjedisit nënkupton shkarkimet e cdo lloj mbetjeje nga pjesë të materialeve të ndryshme në ujë, tokë, ajër e cila shkakton ose mund të shkaktojë probleme mjedisore të përkohshme ose të përhershme në balancën ekologjike të tokës, së bashku me zhvillim e madh që është bërë në industri të ndryshme.

Mbetjet industriale të patrajtuara, emetimet e gazeve të dëmshme në atmosferë, përdorimi i kimikateve pa marrë parasysh dëmet që mund ti sjellin mjedisit kanë sjellë problemet mjedisore me të cilat ne përballemi ditët e sotme. Siperfaqja ku planifikohet te zhvillohen keto aktivitete eshte e paperdorshme momentalisht. Siperfaqe me perdorim ekzistues te pashfrytezuar.

KUSHTET E PUNËS					
Numri total i punonjësve	10				
Shpërndarja e punonjësve	ZYRA	PRODHIMI	MIRËMBAJTJA	MAGAZINIMI	TË TJERA
	2	-	2	4	2
Turnet dhe aktivitetet	Zyrat / Administrata		Instalimet		
	8 ore 08 ⁰⁰ - 16 ⁰⁰		8 ore 08 ⁰⁰ - 16 ⁰⁰		
Orët e punës	Zyrat / Administrata		Instalimet		
	2 pax - 8 orë/ditë = 4.992 orë/Vit		2 pax - 8 orë/ditë = 4.992 orë/Vit		

Numri i orëve të punës në vit	4.992 ore/vit + 44.928 ore/vit = 49.920 ore/vit	
Numri i ditëve të punës në vit	312 Ditë/vit	
Periudhat gjatë të cilave kompania mbyllet	Pushimet	Dita e diel është pushim. Gjithashtu sipas kodit të punës, punëmarrësve u takojnë 24 ditë pushimi në vit.
	Ndërprerje të rregullta të funksionimit	Aktiviteti nuk ka ndërprerje të rregullta të funksionimit.

Struktura Organizative

- Administratori
- Zyra
 - Menaxheri i instalimit
 - Ekonomiste
- Sektori i fraksionimit
- Sektori i magazinimit
- Sektori i mirembajtjes

Aktiviteti ne fjale nuk ka proces prodhimi, por vetem perpunim (copezim/thyerje/fraksionim). Produkti final i nxjerre nga frontoja jane produktet e fraksionuara te mbetjeve inerte, te cilat dalin ne trajta te imeta gati per riperdorim / tregtim.

Rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja

Infrastruktura rrugore është ekzistuese nga ndertimet e bera ne zone, por nese do te jete e nevojshme per akses do te behet hapja e disa rrugëve të reja. Për zhvillimin normal te ketij aktiviteti subjekti do te beje germimin, hapjen dhe sistemimin e siperfaqeve te parashikuara.

Rruget e qarkullimit te brendshem per automjetet do te trasohen sipas projekt-organizimit, sepse do te jene rruge te perkohshme. Ndertimi i tyre behet pasi te kene perfunduar punimet per rrjetin e sherbimeve nentokesore qe rruget te mos demtohen nga nderprerja me kanale per ujesjelles, kablllo etj.

Rruget e perkohshme do te afrohen deri prane themeleve, me qellim qe te arrihet transportimi sa me afer sheshit te punes. Gjeresia e pjeses se trasese per rruget provizore merret zakonisht 3.5 metra. Lloji i mbuleses se rruges duhet te jete i tille qe te lejoje kalimin normal te mjeteve te transportit ne cdo kusht atmosferik.

Ne keto aktivitete nuk do te kete shkarkim te ujerave te ndotura. Ujerat e vetme do te jene ato te shirave dhe ujerat e larjes se mjeteve teknologjike sipas planvendosjes se percaktuar, per te cilat do te ndertohet sistemi i mbledhjes se tyre ne nje pike te perbashket shkarkimi.

6. NDIKIMET NEGATIVE NË MJEDIS

NDIKIMI NE AJER	IDENTIFIKIMI I NDIKIMIT			
	PARA ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARISË		NË STADIN E ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARISË	
	Ka	Nuk ka	Ka	Nuk ka
Emetim i lëndëve të veçanta		X		X
Aroma sulmuese		X		X
Ndikime të tjera klimatike		X		X

Do të ketë shkarkime pluhurash në sektorin e fraksionimit, por relativisht të ulëta. Procesi i punës do të shoqërohet vazhdimisht me lagje me ujë për shmangien e tyre. Punonjësit do të pajisen me maska për mbrojtjen e aparatit respirativ.

NDIKIMI I ZHURMAVE	IDENTIFIKIMI I NDIKIMIT			
	PARA ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARISË		NË STADIN E ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARISË	
	Ka	Nuk ka	Ka	Nuk ka
Zhurma të shkaktuara si rezultat i lëvizjes së mjeteve teknologjike	X			X
Zhurma të shkaktuara si rezultat i punimeve për sistemimin e shesheve	X			X
Zhurma të emetuara nga procesi i fraksionimit	X		X	

Zhurma do të krijohen kryesisht gjatë fazës ndërtimore dhe gjatë procesit të fraksionimit, por parashikohet të jenë brenda normave të caktuara. Nuk do të shkaktohet ndotje akustike në mjediset e banuara pasi ato ndodhen larg zonës së zhvillimit të këtij aktiviteti.

NDIKIMI NE UJE	IDENTIFIKIMI I NDIKIMIT			
	PARA ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARISË		NË STADIN E ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARISË	
	Ka	Nuk ka	Ka	Nuk ka

	Ka	Nuk ka	Ka	Nuk ka
Ndryshimet e nivelit të ujërave		x		x
Ndikimet e ndotësve në cilësinë e ujit		x		x

Ne keto aktivitete nuk do te kete shkarkim te ujerave te ndotura. Ujerat e vetme te gjeneruara do te jene ato te shirave dhe ujerat e larjes se mjeteve teknologjike sipas planvendosjes se percaktuar, per te cilat do te ndertoht sistemi i mbledhjes se tyre ne nje pike shkarkimi.

NDIKIMI NË TRASHËGIMINË KULTURORE	IDENTIFIKIMI I NDIKIMIT			
	PARA ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARISË		NË STADIN E ZHVILLIMIT TË VEPRIMTARISË	
	Ka	Nuk ka	Ka	Nuk ka
	Ndryshime apo dëmtim të zonave arkeologjike, apo me vlera historike e kulturore		x	

NDIKIMI NE TOKE

I gjithë procesi kryhet ne ambjent te shtruar dhe me beton, dhe te izoluar nga depertimi ne sipërfaqen e tokes. Pra, aktiviteti nuk shkakton ndikime ne toke. I vetmi ndikim mund te ndeshet gjate levizjes se mjeteve teknologjike qe bejne te mundur transportin e lendeve te para, mund te kemi rrjedhje aksidentale te lubrifikanteve nga nje avari me pasoje ndotje te tokes. Per te tilla incidente do te merren masa per izolimin total te mjeteve teknologjike dhe te gjitha kushtet e domosdoshme qe ato duhet te kene per nje transport sa me te sigurt dhe pa ndikime ne mjedis.

NDIKIMI NE KLIME

Gjate zhvillimit te aktivitetit nuk priten ndryshime te dukshme klimaterike, si ne drejtim te permiresimit ashtu edhe ne ate te perkeqesimit te saj. Nuk do kete ndryshime ne temperature, ne drejtim te eres, ne sasine e reshjeve. Kryerja e ketij aktiviteti nuk ndikon fare ne kushtet klimaterike te kesaj zone.

RREZATIM JO-JONIZUES

Aktiviteti nuk shoqerohet me rrezatim jo-jonizues.

NDIKIMI NE POPULLESI

Realizimi i projektit nuk do te kete ndikime ne levizjen apo zhvendosjen e popullsisë se rajonit

ku do zbatohet projekti. Gjate funksionimit te impiantit nuk ka emetime ne ajer, toke apo uje te cilat ndotin ambientin dhe te rrezikojne shendetin e punonjesve apo te popullsesise se rajonit.

NDIKIME NE FLORE DHE FAUNE

Zona në te cilen ushtrohet aktiviteti është një zonë pa elemente te spikatur te flores dhe faunes. Keshu qe zhvillimi i ketij aktiviteti nuk ndikon ne te. Subjekti do te shtoje siperfaqet e gjelberta per nje pamje vizuale me te kenaqshme per syrin dhe per te mirat ne pikepamjen mjedisore.

MBETJET

Mbetje qe do te gjenerohen nga ky aktivitet jane mbetjet e ngurta urbane si plastike, leter e karton dhe mbetje te perziera urbane nga personeli. Keto lloj mbetjesh grumbullohen fillimisht ne kontenier ne ambientet e aktivitetit dhe menaxhimi i tyre do te behet po ne zonen e Parkut Industrial te Rrashbullit, permes kontrates me subjekt te licencuar per trajtimin e tyre. Grumbullimi i mbetjeve do te jete i diferencuar qe ne vendburim.

7. MASAT KRYESORE LEHTËSUESE

Masat lehtësuese që do të ndërmerren gjatë ndërtimit dhe shfrytëzimit të objektit

Vlerësimi i ndikimit në mjedis duhet të ndikojë në dhënien e zgjidhjeve për shmangie të ndotjes dhe mbrojtjes së mjedisit. Mbrojtja e mjedisit përbën në vetvete një sërë masash zbutëse, parandaluese.

Në mënyrë të përgjithshme do të japim disa prej masave që do të zbatohen nga kontratuesit për zbatimin e projektit. Ndikimet negative në mjedis gjatë shfrytëzimit të objektit janë në nivele të ulëta. Disa prej masave kryesore që do të ndërmerren janë përmendur në mënyrë të përmbledhur si më poshtë shënuar.

Lloji i masave për mbrojtjen e mjedisit ndahen në:

1. Masa teknike
2. Masa organizative

Kuadri i masave Teknike dhe Organizative

MASA	MËNYRA
Kontrolluese	<ul style="list-style-type: none">- Përzgjedhja dhe trajnimi i personelit.- Kontrolli periodik i gjendjes të pajisjeve/makinerive.- Zbatimi rigoroz i sigurisë gjatë punës.
Ndërhyrëse	<ul style="list-style-type: none">- Riparim i menjëhershëm i defekteve dhe avarive të pajisjeve.- Njoftim i menjëhershëm i autoriteteve dhe njësive të specializuara në rast emergjencash (zjarrfikës, autoambulanca).
Administrative	<ul style="list-style-type: none">- Përdorimi dhe ruajtja me përgjegjësi i të gjithë makinerive sipas skemës/manualeve dhe rregullave.- Ndarje e përgjegjësisë dhe adresimi i saktë për raste të incidenteve/aksidenteve gjatë procesit të punës dhe mënyrat e veprimit.

Masa të tjera që do të ndërmerren

- Kryerja e aktivitetit brenda koordinatave.
- Respektimi i kushteve teknike dhe standarte.
- Zbatimi i rregullores se brendshme.
- Lagje e vazhdueshme me uje e shesheve per shmangien e pluhurave ne ajer.
- Rrethimi i perimetrit te zones ku zhvillohet aktiviteti.
- Disiplinimi i ujerave te reshjeve te shiut.
- Inspektim vizual ditor.
- Rrethimi i objektit me kurore pemesh, duke krijuar nje barriere te gjelber per mos depertimin e grimcave te pluhurit.
- Perdorimi i mjeteve te kolauduara.
- Frontoja do te montohet mbi bazament beton/arme me plinta, per shuarjen e vibrimeve dhe zhurmave.
- Pajisje per mbrojtjen e punonjesve gjate proceseve te tyre te punes.
- Perdorimi i mjeteve te punes dhe te transportit gjate orareve te pershtatshme.
- Vendosja e konteniereve ne ambjentet e jashtme, diferencimi i mbetjeve sipas fraksioneve te gjeneruara.

8. MONITORIMI I PLANIFIKUAR

Qëllimi i monitorimit mjedisor

Te siguroje te dhena nepermjet te cilave te vleresohet nese zhvillimi i veprimtarise eshte ne perputhje me ligjet dhe standartet mjedisore qe lidhen me te, per te vleresuar shkallen e ndikimit (nese ka), si dhe per te vleresuar performancen mjedisore te menaxhimit te saj ne kuader te permiresimit te vazhdueshem.

Objektivat e monitorimit

- Te krahasoje cilesine dhe gjendjen e mjedisit para fillimit te aktivitetit me ate gjate funksionimit te instalimeve.
- Te monitoroje emetimet (nese ka) ne te gjitha fazat e zhvillimit te projektit, ne perputhje me normat dhe standartet ligjore te Shqiperise ne BE.
- Te percaktoje nese ndryshimet e mundshme mjedisore jane si rezultat i zhvillimeve te aktiviteve qe kryhen ne rajonin ku ndodhet objekti ku kryhet funksionimi dhe nese ka lidhje me impakte kumulative me aktivitetin e propozuar.
- Te percaktoje efektivitetin e masave permiresuese te zbatuara nga aktoret zhvillues te aktivitetit ne rajon.
- Per te percaktuar impaktet afatgjata (nese ka).
- Per te percaktuar zgjatjen e kthimit ne normalitet te cilesise se mjedisit ne rajon, ne rastet kur vleresohet se ka ndikime dhe impakte ne te.
- Te krijojte nje arkive (regjister) te cilesise se mjedisit, nje baze te dhenash qe do te mund te perdoret ne te ardhmen.
- Per te garantuar pershtatshmerine e nje objekti mjedisor per ta perdorur per qelime te caktuara.

Plani i Menaxhimit të Mjedisit

Çdo veprimtari e rëndësishme që kryhet në marrëdhënie me mjedisin, duhet të parashikojë në projektin e saj edhe Planin e Menaxhimit të Mjedisit (PMM), qëllimi i të cilit është parandalimi, minimizimi dhe mënjanimi i ndikimeve negative ndaj mjedisit të veprimtarisë që propozohet të kryhet.

Kualifikimi i personelit dhe masat mbrojtëse të përgjithshme. Duhet theksuar që menaxhimi mjedisor është në interes të të gjithëve kundrejt plotësimit të kërkesave. Duhet të zhvillohet një menaxhim ambiental i detajuar dhe një program trajnimi.

Përbërësit kryesorë të këtij programi duhet të ndërthuren si më poshtë:

Informacion i përgjithshëm.

Mirëkuptim i informacionit të përgjithshëm, i konceptit të qëndrueshmërisë dhe arsytet për një

menaxhim mjedisor të mirë.

Përdorimi i pajisjeve/aparaturave të Certifikuara sipas Standartit European dhe Kolaudimi periodik i pajisjeve/aparaturave.

Respektimi i orareve të punës brenda ambientit ku zhvillohet veprimtaria.

Respektimi i masave teknike të punonjësve, sipas rregullores së brendshme.

Diferencimi dhe menaxhimi i mbetjeve të gjeneruara.

Kolaudimi dhe shërbimi i pajisjeve/aparaturave çdo fillim viti për mirëfunksionimin e tyre.

Zëvendësimi i menjëhershëm të pjesëve të pajisjeve / aparaturave dhe mjeteve të punës, në rastet e avarive të mundshme.

Mbajtja e pajisjeve të nevojshme nga punonjësit për operimin e punës si : doreza, kufje per zhurmat; syze etj, sipas nevojës dhe proceseve që zhvillohen.

Trajnimi periodik i punonjësve dhe njohja me planin e ndihmës së shpejtë dhe planin e përballimit të emergjencave të ndryshme.

Monitorimi është detyrë e shoqërisë investitore në nivel individual për pikat C1, C2, C5, C7, C8 të vendimit Nr.1189, datë 18.11.2009 "Për monitorimet në Republikën e Shqipërisë".

Realizimi i objektivave dhe treguesve të pritshëm të parashikuar në projekt do të varet nga respektimi i të gjithë treguesve të përcaktuar. Kontrolli, monitorimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm, sipas kushteve të shfrytëzimit të krijuar gjatë ushtrimit të aktivitetit, do të çojë përfundimisht në përfitimin e pamjeve të parashikuar në projekt me sipërfaqe të sistemuar dhe të gjelbëruar, si dhe me një ambient shërbimi të mirë menaxhuar duke menduar për brezat pasardhës.